



POLICIMI NË KOMUNITET

Materiali informativ që do të gjeni më poshtë, është i përgatitur për t'i ardhur në ndihmë personave me aftësi të kufizuara dhe familjarëve të tyre, me qëllim ofrimin e informacionit të nevojshëm, i cili do të fuqizojë lidhjet dhe komunikimin e tyre me punonjësit e Policisë së Shtetit. Materiali përmban një informacion të thjeshtuar mbi policimin në komunitet dhe parimet e tij. Po ashtu, ai informon mbi rolin e detyrat e punonjësve të Policisë së Shtetit.

ÇFARË ËSHTË POLICIMI NË KOMUNITET?

Policimi në komunitet është policimi që përfshin komunitetin në mënyrë aktive për të zvogëluar, parandaluar dhe zbuluar krimet. Kjo nënkupton partneritetin mes policisë dhe komunitetit në mënyrë që policia vazhdimisht t'u ofrojë qytetarëve shërbime cilësore. Ky partneritet ndihmon policinë në identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve që përbëjnë shqetësim për qytetarët.

PSE DUHET TË PËRFSHIHEN QYTETARËT NË AKTIVITETET POLICORE?

Qytetarët kanë të drejtë dhe detyrim të marrin pjesë në aktivitetet e policisë si obligim për mbështetjen që ata i japin policisë në zbatimin e ligjit. Në një shoqëri demokratike, qytetarët kanë të drejtën e fjalës së tyre lidhur me mënyrën se si qeveriset me ta. Në të njëjtën mënyrë, edhe Policia e Shtetit duhet të reagojë shpejt dhe të jetë plotësisht e përgjegjshme ndaj sigurisë, luftës kundër kriminalitetit dhe për kërkesat e nevojat e komunitetit.

Policimi në Komunitet përfaqëson bashkëveprimin pozitiv me qytetarët dhe ofrimin e shërbimeve për komunitetin. Me bashkëveprim pozitiv dhe shërbim ndaj qytetarëve evitohen disa nga ankesat më të shpeshta të qytetarëve ndaj policisë (p.sh. policia duket se nuk shqetësohet shumë; i konsiderojnë qytetarët si numra e jo si njerëz; keqpërdorin autoritetin e tyre për përfitim personal, nuk marrin parasysh të drejtat e njeriut, etj.).

ÇFARË PËRMIRËSIMI SJELL POLICIMI NË KOMUNITET?

Nëse komuniteti është i lidhur me policinë, ai fillon të shfaqë interesa të përbashkëta dhe të përkrahë policinë në përmbushjen e misionit dhe detyrave të saj funksionale. Kur qytetarët të ndiejnë se ata kanë kontroll mbi fatin e tyre, mund të ndodhin ndryshimet pozitive.

Aktivitetet policore në komunitet inkurajojnë qytetarët që të punojnë së bashku në rritjen e sigurisë së tyre. Po kështu, marrëdhëniet dhe kontaktet me të rinjtë, qytetarët e moshuar,

personat me aftësi të kufizuara, organizatat e ndryshme jofitimprurëse dhe organet shtetërore forcohen më shumë.

PARIMET E POLICIMIT NË KOMUNITET

Përkushtimi

Meqenëse policimi në komunitet është partneriteti ndërmjet Policisë së Shtetit dhe qytetarëve, të dy palët duhet të tregojnë përkushtim.

Punonjësit e Policisë duhet të tregojnë se janë të përkushtuar për përmirësimin e sigurisë së jetesës së popullit të tyre duke i ndihmuar dhe duke i dëgjuar ata. Punonjësi i policisë duhet gjithashtu të jetë i aftë të zgjidhë problemet që kërkojnë nga komuniteti.

Gjithashtu, edhe komuniteti duhet të jetë i përkushtuar të ndihmojë punonjësit e policisë në identifikimin dhe zgjidhjen e detyrave të tyre.

Përkushtimi i punonjësit të Policisë së Shtetit për të gjetur një mënyrë zgjidhjeje të përbashkët për një problem po të përbashkët është e mirë si për policinë ashtu edhe për komunitetin.

Ky përkushtim tregohet me:

- Trajtimin e paanshëm dhe me respekt të të gjithë qytetarëve
- Përgjegjshmërinë
- Zgjidhjen e përbashkët të problemeve
- Ndjeshmërinë kulturore
- Rritjen e sigurisë publike
- Partneritetin dhe konsultimin
- Komunikimin e hapur dhe të sqartë
- Shfrytëzimin efikas dhe real të burimeve të informacionit
- Shërbimin cilësor (kualitativ) dhe të ofruar në kohë.

Besimi

Besimi është i lidhur ngushtë me përkushtimin. Mbi bazat e besimit dhe respektit mes punonjësve të Policisë të Shtetit dhe qytetarëve krijohen raporte të reja. Me policimin në komunitet, policia dhe komuniteti mund të krijojnë raporte që mbështesin njëri-tjetrin.

Kur krijohet besimi, komuniteti tregon gatishmëri për t'i ndihmuar punonjësit e policisë që ata t'u ofrojnë sigurinë komuniteteve.

Njohja e nevojave të veçanta

Policimi në Komunitet pranon se ka qytetarë (si fëmijët, moshuarit, personat me aftësi të kufizuara), nevojat e të cilëve mund të dallohen nga ato të të tjerëve.

Interesimi për komunitetin

Punonjësi i policisë, përfiton mbështetjen dhe bashkëpunimin e qytetarëve kur tregojnë interesim për t'i ndihmuar ata. Kjo arrihet nëpërmjet punës me grupe të veçanta të qytetarëve dhe në tërësi punës me banorët në rritjen e shkallës së sigurisë në zonë apo në komunitet. Është me rëndësi që oficerët e policisë t'i qëndrojnë afër komunitetit, në mënyrë që të forcojnë lidhjet me ta për të minimizuar problemet që kanë të bëjnë me kriminalitetin dhe me shqetësimet e qytetarëve.

Fleksibiliteti (ndryshueshmëria)

Policimi në Komunitet ndihmon në zhvillimin dhe zbatimin e metodave të reja për parandalimin e krimeve në bazë të nevojave të komunitetit. Meqenëse policimi në komunitet ka për qëllim plotësimin e nevojave të banorëve, duhet të jetë fleksibel dhe t'u përgjigjet në çdo kohë problemeve që shqetësojnë komunitetin.

Kalimi nga mënyra reaktive (goditëse) e policimit tek ajo proaktive (parandaluese)

Policimi në komunitet vë theksin mbi parandalimin, bazuar në idenë e logjikshme se përballë asaj që qytetarët çmojnë dhe vlerësojnë, reagimin e shpejtë (goditës) dhe kapjen e personave që shkelin ligjin, ata gjithmonë do të pëlqenin shumë më tepër që të parandalohet viktimizimi i tyre. Themelet e parandalimit të krimit janë pjesëmarrja dhe mbështetja aktive e qytetarëve në programet e ndryshme.

Zgjidhja e problemeve

Punonjësit e policisë zbatojnë ligjin dhe ndërhyjnë në situatat me rrezik të drejtpërdrejtë. Në kushtet kur është rritur përkushtimi dhe besimi, qytetarët tregojnë me shumë vëmendje për problemet e rëndësishme në mënyrë që të arrihet deri tek zgjidhja.

Përmes partneritetit aktiv ndërmjet policisë dhe qytetarëve, të gjitha palët punojnë së bashku për identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve.

SHËRBIMET E POLICISË SË SHTETIT

Zyra e Shërbimeve për Qytetarët (ZSHQ) - është një strukturë në vartësi të Sektorit të Policimit në Komunitet/Seksionit të Policimit në Komunitet, në Drejtorinë Vendore të Policisë dhe Komisariatin e Policisë, e cila është e ngarkuar për ofrimin e shërbimeve për qytetarët dhe zgjidhjen e problemeve shqetësuese të tyre në zonë dhe në qendrën e banimit.

Llojet e shërbimeve që ofron Policia:

Shërbimet që ofron Policia e Shtetit ndaj qytetarëve ndahen në dy grupe kryesore: në fushën administrative dhe në fushën procedurale penale.

1. Shërbimet në fushën administrative përfshijnë:
 - a. Licenca, certifikime personale, certifikime ambienti, autorizime, leje qëndrimi, pasaporta biometrike, shtetësitë dhe shërbime në fushën e qarkullimit rrugor.
 - b. Njoftime, deklarime, raportime, dorëzime dhe regjistrime.
 - c. Vërtetime dhe lëshime dokumente.
2. Shërbimet në fushën procedurale penale: Veprime procedurale penale, kallëzime, denoncime, ankesa dhe informacione.

Nëse keni nevojë të kontaktoni Policinë e Shtetit në zonën tuaj, drejtohu në Zyra e Shërbimeve për Qytetarët, Pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Korçë. Ambientet e kësaj zyre janë të aksesueshme për të pritur persona me aftësi të kufizuara në lëvizje.

Ky material informues është përgatitur në kuadrin e Projektit "Policimi në Komunitet dhe Aftësia e Kufizuar – Partneritet për Përfshirje", me mbështetjen e FCG Swedish Development AB/PMT dhe përmes financimit të Qeverisë Suedeze.

Përmbajtja e këtij udhëzuesi është përgjegjësi e FSHDPAK dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e FCG Swedish Development AB/PMT apo të Qeverisë Suedeze.

Për më shumë informacion kontaktoni:

Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara

Rruga: Bogdani, Nr 1, Tiranë - Shqipëri

Tel: +355 0 4 2 269426

Email: adrf@albmail.com